



## **REAGIM - Bordi i Drejtorëve të organizatës GERMIN**

**26 janar 2021**

Bordi i Drejtorëve të Organizatës GERMIN është duke i përcjellur me shumë kujdes zhvillimet e fundit në Kosovë sa i përket votimit nga jashtë/diasporë në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me 14 shkurt 2021.

Përkundër faktit që qytetarëve të Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit e drejta e votës u garantohet me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi, procesi i ushtrimit të kësaj të drejte vazhdon të jetë i komplikuar. Megjithëse numri i aplikacioneve të pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është çdo herë e më i madh, procesi i ndërlikuar bën që jo gjithmonë të interesuarit për të votuar nga jashtë të regjistrohen dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre. Procedurave tashmë të ndërlikuara, me datën 11 janar 2021 iu shtua edhe një element tjetër pengues, ai për verifikimin e aplikuesëve përmes telefonit. Ne kosinderojmë që ky element cënon barazinë dhe të drejtën e votës për qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës, duke qenë se mund të krijoj rrethana që një personi t'i mohohet një e drejte themelore e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Më tej, aprovimi i këtij vendimi vetëm një ditë para fillimit të procesit të regjistrimit të votuesve nga jashtë dhe mungesa e një vlerësimi dhe planifikimi paraprak nga KQZ, e bën atë edhe më të paarsyeshëm dhe të papranueshëm dhe shpërfaq mos gatishmërinë e KQZ për të trajtuar me seriozitet këtë proces.

Sikurse në zgjedhjet e kaluara edhe këtë vit organizata GERMIN është zë i mbrojtjes së të drejtave zgjedhore të pjesëtarëve të diasporës. GERMIN ka sjellë poashtu një [analizë](#) të detajuar pas zgjedhjeve të vitit 2019, e cila synon të adresojë pengesat e votimit nga jashtë me qëllim të lehtësimit të procesit dhe rritjes së numrit të votuesëve nga diaspora. Gjithsesi, pavarësisht rekomandimeve konkrete të dhëna nga GERMIN, ky proces vazhdon të përcillet me probleme të vazhdueshme, ndoshta edhe nga fakti se vendimmarrësit nuk kanë arritur apo nuk kanë pasur vullnet të bëjnë ndryshimet e nevojshme dhe të kërkuara.

Theksojmë se Diaspora jonë nuk mund të reduktohet në vetëm kontribues financiar dhe profesional, me lidhje emocionale me vendin e origjinës, por edhe si subjekt me të drejta kushtetuese dhe interesa të veçanta, të cilat duhet marrë parasysh në proceset vendimarrëse në Kosovë. Krijimi i politikave lehtësuese, mbrojtja e të drejtave si ajo e votës janë të rëndësishme për nxitjen e angazhimit dhe përfaqësimin e diasporës në vendin amë.



Duke marrë parasysh rëndësinë dhe ndikimin që diaspora ka në zhvillimin socio-ekonomik të vendit, ne si një organizatë me përbërjen të plotë të bordit nga pjesëtarë të diasporës dhe me një rrjet të gjerë profesionistësh e organizatash nga vende të ndryshme të botes, i bëjmë thirrje KQZ-së që të trajtoj me seriozitet maksimal ushtrimin e të drejtës së votës të qytetarëve që jetojnë jashtë Kosovës, ashtu sikurse e obligon Kushtetuta dhe Legjislacioni në fuqi.

Poashtu, ky është një moment i rëndësishëm për të kuptuar kushdo që do të përbëj legjislaturën e re të Kuvendit të Kosovës, të krijojë lehtësira për pjesëmarrjen e diasporës në zgjedhje në mënyrë që të mos i mohohet asnjë personi e drejta themelore e votës për shkaqe teknike që dalin jashtë përgjegjësisë së tij/saj.

Ne jemi të gatshëm të mbështesim këto përpjekje dhe të ofrojmë ekspertizën tonë, të krijuar me vite të angazhimit në raport me diasporën.

Me mirësi,

**Mark Kosmo**, Kryetar i Bordit

**Avni Mustafaj**, anëtar

**Anila Hyka Smorgav**, anëtare

**Anita Gjidoda**, anëtare

**Gaspër Sopi**, anëtar

**Hilmi Gashi**, anëtar

**Gazmend Salihi**, anëtar